



**REPUBLIKA E KOSOVËS /
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO**

C.nr.153/10

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, në përbërje nga gjyqtari Lumni Sallauka, me sekretaren juridike Raxhije Emimi, në çështjen juridike të paditësit Doganat e Kosovës, me seli në Prishtinë, kundër të paditurit C. (D.) T. nga Mamusha, me objekt të padisë kompensimin e dëmit, vlera e kontestit 1,304.00 €, me datën **04.03.2014**, mori këtë:

A K T G J Y K I M
-për shkak të mosbindjes-

I. APROVOHET në tërësi kërkesëpadija e paditësit Doganat e Kosovës, me seli në Prishtinë, me seli në Prishtinë.

II. DETYROHT i padituri C. T. nga Mamusha, që paditësit në emër të kompensimit të dëmit, t'i paguajë shumën prej 1,304.00 €, me kamatë vjetore e cila llogaritet për mjetet e afatizuara mbi 1 vit në bankat komerciale në Kosovë, duke filluar nga data e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas pranimit të aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Doganat e Kosovës, me seli në Prishtinë, kanë parashtruar padi, kundër të paditurit C. T. nga Mamusha, me objekt të padisë kompensimin e dëmit.

Me aktvendimin C.nr.153/10, datë 02.10.2013, të marr në bazë të nenit 394 të LPK-së, gjykata e ka obliguar të paditurin që në afat prej 15 ditësh nga dorëzimi i padisë me të gjitha provat materiale, të paraqes përgjigje në padi në formë të shkruar në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palën paditëse, nën kërcënim të pasojave procedurale. Këtë aktvendim i padituri e ka pranuar me datë 09.10.2013, mirëpo deri në marrjen e këtij aktgjykimi i njëjti nuk i ka dorëzuar gjykatës përgjigje me shkrim në padi.

Andaj, gjykata bazuar në nenin 150 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (Ligji Nr.03/L-006), vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, meqenëse janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me parag.1 pika a), b) dhe c) të nenit 150 të LPK-së, ndërsa në anën tjetër gjykata nuk gjeti ndonjë pengesë ligjore të paraparë

me nenin 150 parag.3 dhe 4 të ligjit të sipërpërmendur, të cilat do të ndikonin në mos marrjen e këtij aktgjykimi (në shkresat e këndës gjendet aktgjykimi penal i formës së prerë P.nr.1357/07, me të cilin i padituri është shpallur fajtor dhe në të njëjtën kohë është përcaktuar edhe shuma e dëmit të shkaktuar këtu paditësit).

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori konform nenit 450 të LPK-së, pasi që paditësi në padi nuk ka specifikuar se çfarë shpenzime të procedurës i kërkon, ndërsa referuar dispozitave të Ligjit mbi Taksat Gjyqësore, i njëjti edhe është i liruar nga pagesa e taksës gjyqësore, meqenëse është organ shtetëror.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C.nr.153/10, datë 04.03.2014

Sekretare Juridike,
Raxhije Emini

Gjyqtari,
Lumni Sallauka

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas pranimit të të njëjtit, në Gjykatën së Apelit në Prishtinë, ndërsa ankesa dorëzohet nëpërmjet kësaj gjykate.